



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2018

Lënda: Shtojcë mbi Modifikimin dhe ndryshimin e Dokumentave Standarte Të Tenderit

Sot më datë 03.12.2018, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Në bazë të Nenit 42 pika 2, të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut VII Neni 62, kreu X, neni 78, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për procedurën **E hapur mbi kufirin e lartë monetar** të prokurimit me objekt: **“Loti i II-te” Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Lindore**, REF-94214-11-14-2018, me fond **101 121 392** (Njëqind e njëmilion e njëqind e njëzet e njëmijë e treqind e nentëdhjetë e dy) leke pa tvsh, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë së Shkodër Njësia e Prokurimit, vendosi të bëjë ndryshimet përkatëse në Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit me objekt **“Loti i II-te” Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Lindore**, si më poshtë vijon:

1. Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimi, kapaciteti teknik pika 2.3.9.

ISHTE

- Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (për pastrim, larje dhe fshirje rrugësh), (Kodi III.1.B)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Ndikimin në Mjedis (kodi III.2.A)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)

BEHET

- Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit sipas objektit të prokurimit, Kodi III.1.(A/B ose C)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)

Ju lutemi operatorëve ekonomikë që do të paraqesin ofertat e tyre për këtë procedurë të marrin për bazë Shtojcën mbi modifikimin dhe ndryshimin e Dokumentave Standarte të Tenderit në platformen elektronike të APP –së.

Sa më sipër Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 42 pika 2 dhe pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në bazë të Kreut VII , Neni 62 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, vendosi të bëjë ndryshimet në dokumentat e tenderit përmes hartimit të një shtojce e cila u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për ta.

Nisur nga ky fakt, Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 42 pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në bazë të Kreut VII , Neni 62 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, vendosi të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 (pesë) ditë kalendarike.

Njësia e Prokurimit njofton të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës se afati kohor për dorëzimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: **“Loti i II-te”Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Lindore**”, është si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 14.01.2019, Ora: 10:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 14.01.2019, Ora: 10:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, www.app.gov.al